



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

SENATI AKADEMIK

Nr. 2646 prot.

Shkodër, më 04.09, 2024

V E N D I M

Nr. 186, datë 04.09.2024

**"Për miratimin e disa ndryshimeve në programin e studimit Master i shkencave në
"Studime të Historisë dhe Kulturës Shqiptare"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa dh, Nenet 73 dhe 75; Statutit të USH-së, Neni 17, pika 6, germa f, Nenet 51-53; VKM-së nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të", i ndryshuar me VKM-në nr.879, datë 18.12.2019; në Vendimin nr.13, datë 05.07.2024 të Dekanatit të FSHSH-së, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e krediteve për lëndët me zgjedhje, në mbledhjen e tij të datës 04.09.2024

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet e krediteve në planin mësimor Master i Shkencave në "Studime të Historisë dhe Kulturës Shqiptare, për lëndët me zgjedhje "Filozofi e historisë" dhe "Etnolinguistikë" dhe secila prej tyre të ketë 2 (dy) pikë kredite.
2. Ngarkohen Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Drejtoria e Kurrikulave, kërkimit shkencor dhe standardeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonin GJURAJ

